VENDIM
Nr.7, datë 13.10.2005

PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME "ALBTELEKOM"" DHE EKSPERTIZËN NDËRKOMBËTARE NË LIDHJE ME TË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit "Për ratifikimin e kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime "Albtelekom"".

II. Këshilli i Ministrave të sigurojë ekspertizë ndërkombëtare në lidhje me formulimet e kontratës, si dhe për ligjshmërinë e procedurave të ndjekura në privatizimin e "Albtelekom" sh.a.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja